- a. Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur **Kontratën e nënshkruar me institucionin dhe vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kompletimi i furnizimit të kontraktuar dhe vlera e furnizimit të realizuar.**
  - b. Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur faturat tatimore përkatëse të shitjes të nënshkruara nga të dyja palët (**ku te shprehen qarte datat, shumat dhe furnizimet e realizuara**).
2. Operatori ekonomik duhet të të jetë i pajisur dhe duhet të paraqesë liçencë të vlefshme profesionale, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, me kategorinë:
- **N.S-14 A - Impiante, të brendshme elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.**
3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015, ose i përditësuar (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO IEC 27001:2013, ose i përditësuar (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
5. Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe menaxhimin me profesionalizëm të punës, duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:
- 5.1 Një punësim mesatar i të paktën 10 (dhjete) personave , për periudhën **Janar 2018 - Korrik 2018** të vërtetuar me:
- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën **Janar 2018- Korrik 2018**.
- 5.2 Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se ka në stafin e tij punonjës të diplomuar:
- a. 2 (dy) inxhinierë të diplomuar për informatikë, elektronikë ose telekomunikacion.
  - b. 2 (nje) teknik elektrik
- 5.3 Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se ka në stafin e tij punonjës të pajisur me “Dëshmi Kualifikimi për Sigurimin Teknik”:

## Dokumentat standarde të tenderit “ *Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande* “

- a. 2 (dy) teknik elektrik – Kategoria IV
6. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka në stafin e tij punonjës specialistë me këto kompetenca:
  - a. 1 (një) specialist të certifikuar për mbështetjen e kontratës sipas praktikave të ITIL ose praktikave ekuivalente.
  - b. 2(dy) specialiste te certifikuar per sistemin e parkimit te propozuar.
- Për të vërtetuar kërkesat e mësipërme të stafit operatori ekonomik duhet të paraqesë:
  - Certifikatat përkatëse (dëshmitë përkatëse)
  - Kontratat e punës (te vlefshme)
  - Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025 ku të përfshihet stafi i mësipërm për periudhën **Janar 2018-Korrik 2018**.
7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar per **pajisjen Kase per hyrje /Dalje dhe barriere automatike** me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon operatorin ekonomik të ofertojë këto pajisje në këtë procedurë prokurimi. Për rastin kur autorizimi është lëshuar nga distributori i autorizuar, ai duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin e autorizuar.
8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Katalogët përkatës në formë elektronike në [app.gov.al](http://app.gov.al). Në katalog **duhet markohet me ngjyrë pajisja që ofrohet dhe të pasqyrohen përputhshmëria e specifikimeve teknike të kërkuara për këto pajisje. Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.**

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

### Shtojca 9

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

#### SPECIFIKIMET TEKNIKE

#### Objektivi i procedures se prokurimit

## Dokumentat standarde të tenderit “ *Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande* “

Permes ketij projekti, Drejtoria e Spitalit Sarande, ka si objektiv vendosjen e nje sistemi parkimi ne ambjentet e tij per sherbimin ndaj qytetareve si dhe punonjesve te administrates, duke rritur ne kete menyre performancen e sherbimeve ne institucion.

### SISTEMI I BILETARISE se MENAXHIMIT TE AUTOMJETEVE

- Parkimi do te pajiset me Sistem te Menaxhimit te Automjeteve te kontrolluar.
- Te gjithë pajisjet do te jene me konstrukcion te forte, rezistente ndaj vandalizmave dhe rezistente ndaj motit.
- Barrierat hyrese do te jene te mbushura me sinjale automatike ndriçuese.
- Fotocelulat IR te sigurise do te jene te mundura ne te gjitha barrierat.
- Sistemi i kontrollit qendror do te jepet grafikisht dhe do te siguroje nje raport ne kohe reale per te gjithë statusin e sistemit.
- Sistemi do te pranoje nje sinjal ne raste zjarri qe do te mbylli te gjitha hyrjet dhe te hape te gjitha daljet

Konfigurimi i Sistemit Per menaxhimin e parkimit do beje te mundur Sistemin e Menaxhimit te Automjeteve. SMA do te perbehet nga barrierat e makinave automatike dhe lexuesit e kartes qe do te jene te pozicionuar ne hyrje dhe ne dalje. Lexuesit e kartes do te jene pjese e kontrollit te sistemit te hyrjes. Pervec lexuesit te kartes ne hyrje do te jete e mundur qe barriera te kete nje hapje manuale nga dhoma e sigurise. Fotocelulat IR te sigurise do te jene te mundura ne te gjitha barrierat. Te gjithë kontrollet e barrieres do te jene te lidhura me njera-tjetren ne bus me RS-485 ose me tip te ngjashem dhe perfundojne ne dhomen e sigurise ku do te jene te monitoruara ne kohe reale per gjendjen e tyre. Monitorimi dhe kontrolli do te behet nepermjet software-it. Nderfaqja eshte e domosdoshme ndermjet RS-485 ose tipeve te ngjashme qe vjen nga PC ne vendin qe do jete instaluar software-i. Ne rast te alarmit te zjarrit do te tejçohet nje sinjal direkt te barrierat per te mbyllur hyrjen dhe hapur daljen. Pas rivendosjes se sinjalit sistemi do te kthehet ne pozicionin e tij te meparshem ne drejtim e te gjitha variablave. Parkimi do te operoje ne dy menyra: me karte kontrolli hyrje dhe me bilete. Biletat do te mundesohen ne hyrje dhe do te paguhen ne Qendren e Kontrollit. Pas pageses se biletas do te operohet ne dalje per hapjen e barrierave.

Ne parkim do te instalohen pajisjet e meposhtme:

Ne hyrje

- ♣ Kase hyrese
- ♣ Barriere automatike
- ♣ Loop-e te sigurise ose/dhe fotocelule IR
- ♣ Lexues karte
- ♣ Kamera OCR

Ne secilen dalje

- ♣ Kase dalese
- ♣ Barriere automatike
- ♣ Loop-e te sigurise ose/dhe fotocelule IR
- ♣ Lexues karte

# Dokumentat standarde të tenderit “ *Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande* “

## Njesite Hyrese/Dalese

### 1. Kase hyrese dhe dalese

Stacioni i hyrjes per menaxhimin automatik te hyrjeve si per perdoruesit e rastit ashtu edhe per te abonuarit. Komplet i software-it te menaxhimit nepermjet Ethernet Sistem Operativ Windows Embedded me teknologjine e magazinimit te te dhenave pa pjese te levizshme, SSD dhe mikroprocesorit x86 ne gjendje te menaxhoje te gjitha pajisjet e brendshme te aparatit.

- Ekran me prekje TFT jo me I vogel se 7” qe punon ne temperatura te jashtme ( -30C deri +85C), ekrani duhet te kete ndricim jo me pak se 650cd/m<sup>2</sup>
- Sistemi duhet te drejtoje automatikisht qytetaret per veprimet e hyrjes ose te daljes ne parking
- Printer biletash Termica barcode fanfold, kod QR dhe shirit magnetik
- Kabina te realizuara me celik te lyer, AISI 430 me trashesi 2mm.
- Kabina duhet te jete e pajisur me sistem alarmi ne rast hapjesh te paautorizuara.
- Lexues NFC
- Lexues i Chip dhe Shiriti Magnetik i kartave te debitit/kredit, tastira me shifra per teshkruar PIN e kartes.  
Ne menyre qe njesite e hyrjes dhe daljes te jene funksionale dhe lehtesisht te perdorshme nga drejtuesit e te gjitha llojeve te automjeteve, modulet e pageses dhe sherbimit duhet jene fizikisht te vendosura ne intervalin 750 mm- 1150 mm ngatoka.
- Sensor për njohjen e derës së hapur / mbyllur për të dy portat.
- Lidhje me rrjetin ethernet me protokoll TCP/IP - HTTP
- Lexues imager per kodet e barrave 1D dhe 2D
- Totem me kamera te cilat lexojne targat, per te mundesuar menaxhimin automatik te abonenteve
- Webcam te integruara
- Ushqyesi 100-120/220-240 V AC 50-60 Hz
- Shkalla e mbrojtjes IP54
- Temperatura e punes -20° / + 55°C

#### *Shkalla e mbrojtjes*

- UNE-EN 20324 (EN 60529). Shkalla e mbrojtjes: IP54.
- UNE-EN 50102. Shkalla e mbrojtjes kundër goditjeve të jashtme: IK10.

Produktet duhet te jene te pajisura me CE.

**Monitorimi,Raportet dhe kontrolli do te behet nepermjet software-it ne Gjuhen Shqipe.**

## Dokumentat standarde të tenderit “ *Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande* “

Software i Sistemit te Parkingut Mundeson :

- 1.Raporte te personalizuara per cdo Operator.
- 2.Raporte te pergjithshme(Javore,Mujore,Vjetore)
- 3.Raporte Ditore
- 4.Raporte te Hyrje Daljeve.
- 5.Monitorim On-Line ne Distance, dhe marrja dhe hedhja e te dhenave nga distanca
- 6.Raporte mbi Hyrje dalje Manuale,Arka,Shitjet...etj

### **2. Barriere e shpejte per perdorim intensiv (fast-intensive)**

*Krahët e barrierave automatike do të instalohen në hyrje dhe dalje të parkimit.*

- Tra i shpejt përdorim intensiv për pasazhe deri në 2,7 m
- Koha e hapjes <2s
- Impakti në goditje I traut duhet të jetë i certifikuar sipas EN 12445
- Steke me shirit LED
- Te pajisur me një firmware të veçantë të sigurisë, të integruar me menaxhimin e sistemit të parkimit
- Opsioni për njohjen e automjeteve.
- Shkalla e mbrojtjes: IP54
- Njohje automatike e rënies së stekes

Protokoll komunikimi i dedikuar midis stacionit hyres dhe barrieres, në gjendje që të njohë pozicionin e barrieres në distancë (rrjet) (të hapura, të mbyllura, hapjen, mbylljen, të metat

Public Health Sector

### **3. Ndertimi i kabines se operatoreve**

#### **Qendra e Kontrollit te Parkingut.**

Stacioni qendror i kontrollit konsiston në ndertimin e Kabines se Operatoreve te monitorimit te Sistemit te Menaxhimit te Automjeteve dhe te Sistemit CCTV. Stacioni qendror i kontrollit ,do të ndertohej me strukture Profile Hekuri ose Alumini, Veshje me panel termoizolues, xhama të temperuar rezistente ndaj kushteve atmosferike. Qendra e Kontrollit te Parkingut duhet të dorezohet me sistemin e ndricimit elektrik dhe Menaxhimit te Automjeteve.

Në Stacioni qendror i kontrollit do të instalohet edhe një kompjuter me **procesor jo më të vogël se 55000 pike** dhe një monitor 22” për të monitoruar të gjithë vendet dhe për të kontrolluar pamjet e regjistruara nga Sistemi CCTV. Programi i monitorimit duhet të lejojë klientet të monitorojnë disa vende nga një përdorues i vetëm.

Te jete i perfshire dhe nje workstation **procesor jo me te vogel se 65000 pike** për të monitoruar dhe ruajtur të dhënat e kamerave OCR për funksionimin normal të sistemit  
Permasat e **Qendra e Kontrollit te Parkingut.**

Gjeresia 1300 x Gjatesia 1600 x Lartesia 2000.

Duhet të ketë sirtar për të mbajtur leket  
Skaner për leximin e biletave barcodi

## Dokumentat standarde të tenderit “ *Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande* “

### 4. Kamera OCR ose ekuivalente 2 cope

- Sistem kamerash qe lexojne targat me telekamera OCR per leximin e targave hyrese dhe dalese ne sistemet e parkimit me pagese.

Sistemi i kamerave duhet te kete nje shkalle saktësie jo me te vogel se 99%.

Duhet te kete nje sistem smart njohjeje qe te krijojë lidhjen midis targes ne hyrje dhe dalje ne menyre qe te shmangen rastet e parregullsive, vjedhjet, etj.

- shkalla e mbrojtjes ip65
- funizimi 110-240 ac/ v-50/60 hz 12 ac poe-ieee 802 3af
- konsumi max w 15
- temperatura -20 +55 grade
- te kete opsione per tu integruar me barrieren stacionin e hyrjes dhe daljes me ane te Switcheve.
- Te kete opsion per spiren magnetike, Opsion dhe per konfigurim nga Remote.Njohje te targes per mjetet e abonuar ne shesh, per ta te realizohet hapja automatike e tra hyres dhe dales.

### Sistemi CCTV

Sistemi CCTV perbehet nga kamera fikse te insaluara ne sheshin e parkimit per te monitoruar pjesen e levizjes se makinave per te siguruar cilesi te larte mbikqyrjeje. Kamerat do te vendosen ne pozicionet we mepashtme:

1(nje) kamer do te vendoset tek godina kryesore te spitalit nga ana e hyrjes se sherbimit .

1(nje ) kamer do te vendoset tek godina perballe godines se sherbimeve .

1(nje kamer do te vendoset tek parkimi i mjeteve te administrates ne nje nga shtyllat e ndricimit qe eshte egzistuese.

Parkimi do te kete grupin te kamerave dhe pajisjeve CCTV te vendosura ne Qendra e Kontrollit te Parkingut. Te gjitha kamerat do te lidhen me kabell. Qellimi i Sistemit te monitorimit me Kamera eshte monitorimi i trafikut dhe i hyrje daljeve te Parkingut.

### Sistemi permban:

- Kamera, fikse, me ngjyra (3 cope )
- Ushqyes per lidhjen e kamerave dhe furnizimin e tyre
- Pajisje rregjistruese per manaxhimin dhe regjistrimin e videove. ( 1 Cope )

### Network -Video-Regjistrator Rrjeti 8 CH (1 copë)

Numri i kanaleve hyrëse	8 kanale ose më shumë
-------------------------	-----------------------

**Dokumentat standarde të tenderit “ Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande “**

Gjerësia e bandës hyrëse dhe dalëse	200 Mbps në hyrje;200 Mbps në dalje
Rezolucioni maksimal në regjistrim	12 MP
Synchron Playback	4 kanale
Formati i Videos	H.265+, H.264, MPEG-4
Numri minimal i Hard-disqeve	2
Kapaciteti fizik i disqeve	SATA 2TB,3TB, 4TB, 6TB
Porta e rrjetit	1x RJ45 (1000BASE-T, 100BASE-TX)
Portat USB	1xUSB 2.0 ose më shumë;1xUSB 3.0 ose më shumë
Video Output	RGB, 1x HDMI
Audio Input dhe Output	Po
Temperatura e operimit	-10°C deri 50°C
Aksesore per montimin ne Rack	Te gjitha te perfshira
Ushqimi “Power Supply”	220 V / 50 Hz

<b>Monitor 22” Led Full HD</b>	
Model	LCD
Madhesia Ekranit	Jo me te vogel se 22”ania
Resolucioni	1080 P
Portat	Minimumi 1 porta HDMI, 1 portaVGA.

**UPS 2000VA**

Fuqia” “Power”	2000VA
Faktori i fuqisë “Power Factor”	≥0.8
Forma e valës “Wave Form”	Sinusoidale
Tensioni nominal “Nominal Voltage”	220-240 VAC
Frekuenca “Frequency”	50 Hz +/- 2%
Rregullimi i Tensionit “Volt, regul. (On battery)”	+/-5%
Prizat dalëse “Output Connectors”	≥ (6) IEC 320 C13 (nga bateria)
<b>HYRJE “INPUT”</b>	
Tensioni nominal “Nominal Voltage”	220-240 VAC
Frekuenca	50 Hz
Dritarja e tensionit “Voltage window	170 – 270 VAC
Rregullim automatic i Tensionit “AVR”	Po
<b>KOMUNIKIMI &amp; MENAXHIMI</b>	
Programi i fikjes “Shutdown Software”	Po
Sinjalizim me dritë “Led indicators”	Për të gjitha gjendjet



**Dokumentat standarde të tenderit “ Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande “**

Sinjalizim me zë “Audible indicators”	Për të gjitha gjendjet
Prizë për komunikimin e të dhënave “Data”	(1) DB9 Serial ose USB
Mbrojtja ”Protection”	Overload, Discharge, and Overcharge Protection
<b>AKSESORËT</b>	
Kabëll për komunikimin data” Data cable”	(1) DB9 Serial - DB9 Serial ose USB-USB

**Kamera e Jashtme**

<b>Karakteristikat</b>	<b>Vlerat specifike minimale</b>
Tipi i kamerës	OUTDOOR Bullet
Procesori i figurës	Progressive Scan CMOS sensor 1/2.9”
Rezolucioni i figurës	≥ 4 megapixel
Frekuenca e kuadrove	30 fps @ 1920x1080
Reduktimi i zhurmës	2D/3D
Tipi i lenteve	Vari -focal
Gjatësia fokale	2.7 mm -12 mm
Ndeshmëria dritës në 50 IRE, F1.2	Color 0.01 lux; B/W 0 lux with IR
Ndriçimi Infra të Kuqe	80 m
Rezistenca ndaj pluhurit dhe shiut	IP66
Ditë/Natë	True Day/Night (IR cut filtër)
Rezistenca ndaj vandalëve	IK10
Diapazoni dinamik i dëshëmërisë,	100 dB
Formati i kompresimit të Videos	H.264, MJPEG
Dedektim i lëvizjes	Po
Alarm për rast sulmi/sabotimi të kameras	Po
Detektim i hyrjes në zona	Po
Pajtueshmëria e sistemit	ONVIF
Multi-streaming	Dual stream
Temperatura e operimit	-20°C ne 50°C
Ushqimi	PoE,IEEE802.3 af/at
Protokollet e rrjetit	IP v4, IP v6, UDP, ICMP, HTTP, DHCP, DNS, RTP, RTSP, SMTP, NTP, SNMP, PPPoE, HTTPS, FTP, 802.1x, QoS
Aksesore per montimin	Te gjitha te perfshira

Pajisjet e regjistrimit do te jene me cilesi regjistrimi me minimumi 3 kamera ne nje minimum prej 60

**Dokumentat standarde të tenderit “ Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande “**

ditesh ruajtje te regjistrimit. Keto regjistruesisit do te jene plotesisht te programueshem per funksione kohe,dhe te monitorohen online nga distanca.

**Hard Disqe Industrial (purple HDD) për NVR (2 copë)**

SATA 4TB

- Te jete i dizenuar për punë me intensitet të lartë dhe pa ndërprerje.
- Te jete i përshtatshëm për sisteme regjistrimi të videove

Switch Me 8 Porta

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi, "Type":	Switch Gigabit i Menaxhueshëm 8 Porta
Numri i Portave Ethernet "Number of Ethernet Ports" :	8 Porta Gigabit
Menyrat e Forward-im, "Forwarding modes":	Store-and-forward
Protokollet e Rrjetit IEEE, "IEEE Network Protocols":	IEEE 802.3 Ethernet IEEE 802.3ab 1000BASE-T
Certifikimi i Produktit, "Certification":	CE mark
Aksesorët e Përfshirë, "Accessories Included":	Power Supply Power Adapter Quick Install Guide
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vit

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Nr.	Pershkrimi	Sasia
1	Kase ne Hyrje me Bilete	1
2	Kase ne dalje me bilete	1
3	Barriere Automatike	3
4	Kase Manuale	1
5	Akses Kontrolli	1
6	Bileta	5000
7	Kompjuter+Monitor	1
8	Vendroje (Kabine Kontrolli + pajisje sigurie)	1
9	Pulte komandimi per barrierat	17

## Dokumentat standarde të tenderit “ *Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande* “

### KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.



Dokumentat standarde të tenderit “ *Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande* “

**Shtojca 10**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**

<b>Nr.</b>	<b>Pershkrimi</b>	<b>Sasia</b>
1	Kase ne Hyrje me Bilete	1
2	Kase ne dalje me bilete	1
3	Barriere Automatike	3
4	Kase Manuale	1
5	Akses Kontrolli	1
6	Bileta	5000
7	Kompjuter+Monitor	1
8	Vendroje (Kabine Kontrolli + pajisje sigurie)	1
9	Pulte komandimi per barrierat	17

**GRAFIKU I LËVRIMIT**

Afatet e lëvrimit: **30 dite nga dita e nenshkrimit te kontrates**



Dokumentat standarde të tenderit “ *Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande* “

**Shtojca 11**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër*]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>		
<b>02</b>		
<b>03</b>		
<b>...</b>		



Dokumentat standarde të tenderit “ *Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande* “

**Shtojca 12**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>1</sup>**

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. **Me keqardhje ju informoj** se u s’kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme: \_\_\_\_\_

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >

**Dokumentat standarde të tenderit “ Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande “**

**Shtojca 13**

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

**Public Health Sector**

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

**Dokumentat standarde të tenderit “ *Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande* “**

\*\*\*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_



[Titullari i autoritetit kontraktor]



**Dokumentat standarde të tenderit “ *Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande* “**



**Dokumentat standarde të tenderit “ Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande “**

**Shtojca 14**

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

**Dokumentat standarde të tenderit “ Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande “**

Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)


2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë \_\_\_\_\_ numri i NIPT-it \_\_\_\_\_

Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_



Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 15

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME** **Mallrat –Kërkesë për propozim**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi,

## **Dokumentat standarde të tenderit “ *Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande* “**

- tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikant e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

## **Dokumentat standarde të tenderit “ *Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande* “**

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Pronësia Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t’i përdorë për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t’i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

### **Neni 7: Origjina e Mallrave**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

## **Dokumentat standarde të tenderit “ *Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande* “**

7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

### **Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet**

8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.

8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

### **Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike**

9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.

9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.

9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.

9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitesit (Kontraktuesit).

### **Neni 10: Pjesët e Këmbimit**

10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozite përkatëse të kontratës.

10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen

## **Dokumentat standarde të tenderit “ *Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande* “**

bashkë me Mallrat.

- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t’i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t’i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

### **Neni 11: Ambalazhimi**

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe paketuar në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe paketuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

### **Neni 12: Testimet dhe Inspektimet**

- 12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspekteve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës
- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.
- 12.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t’i kërkojë Kontraktuesit të bëjë teste ose inspekte shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Mallrat janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do të pranojë të ndryshojë grafikun e lëvrimin.
- 12.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Mall që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 12.5 Ekzekutimi i testeve, apo inspektimi i Mallrave nuk e shkarkojnë Kontraktuesin nga garancitë apo detyrimet e tjera sipas kontratës.



## **Dokumentat standarde të tenderit “ *Furnizim - vendosje barrierave elektronike ne parkimet e spitalit Sarande* “**

### **Neni 13: Kushtet e Dorëzimit**

- 13.1 Kontraktuesi është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit përveçse kur Kontraktuesi përjashtohet në mënyrë specifike nga një aktivitet ose veprim i tillë nga ndonjë dispozitë e kontratës. Nëse një Incoterm përdoret për të përshkruar detyrimet e palëve, termi do të ketë kuptimin që i ka dhënë botimi i fundit i *Incotermave* botuar nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.
- 13.2 Vendi i dorëzimit të Mallrave do të jetë sipas specifikimit të kontratës.
- 13.3 Koha e dorëzimit të Mallrave dhe data e përfundimit të Shërbimeve të lidhura me to do të jetë sipas specifikimit në kontratë.
